

UDHËZIM
Nr. 17, datë 5.7.2022

**PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR**

(ndryshuar me udhëzimin nr. 9, datë 21.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi i vlerësimit të nxënësit

Vlerësimi është proces gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënësit, duke u bazuar në nivelet e arritjes. Qëllimi i vlerësimit është gjykim i mbi arritjet e nxënësit, duke iu referuar përmbajtjes së kurrikulës që bazohet në kompetenca, si dhe mbështetja e të nxënësit dhe përparimit të nxënësit. Ky qëllim përmbushet nga kombinimi i vlerësimit për të nxënë dhe i vlerësimit të të nxënësit, mbështetur në kornizën e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar, miratuar më datë 23.7.2015, nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

Neni 2

Vlerësimi për të nxënë

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a) vlerësimit të vazhduar;
- b) vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- c) vlerësimit me projekt kurrikular.

Neni 3

Vlerësimi i vazhduar

1. Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënësit, në situata të ndryshme, të njohura dhe të panjohura.

2. Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, si dhe në teknika të tjera të vlerësimit të nxënësit.

3. Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër dhe ia komunikon nxënësit, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv, i argumentuar dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe.

4. Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë për lëndët që zhvillohen me 1–2 orë në javë dhe të paktën 3 vlerësime me notë për lëndët që zhvillohen me 3 ose më shumë orë në javë.

5. Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë, duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër. Mësuesi vlerëson nxënësit për njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënësit, në programin lëndor.

6. Mësuesi ka për detyrë të informojë personin që ushtron përgjegjësinë prindërore dhe nxënësin mbi ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

Neni 4

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

1. Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të masë nivelin e arritjeve të nxënësit për rezultatet kryesore të të nxënës, për secilën periudhë.
2. Në lëndë të tilla, si: edukim fizik, sporte dhe shëndet; art pamor; muzikë; kërcim; teatër; TIK; aftësim teknologjik, vlerësimi bëhet vetëm me detyrë përmbledhëse. Mësuesi përcakton detyrën përmbledhëse në përputhje me veçoritë e lëndës dhe duke marrë parasysh nivelet e arritjes për lëndën përkatëse. Në lëndët e tjera, mësuesi vendos për përcaktimin e metodës së realizimit me test ose me detyrë përmbledhëse, sipas specifikave të lëndës.
3. Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me mësuesit menaxhon kohën e zhvillimit të testeve ose të detyrave përmbledhëse, me qëllim që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të periudhës.
4. Vlerësimi i testit/detyrës përmbledhëse pasqyrohet në regjistër, në kolonën përkatëse.
5. Testet/detyrat përmbledhëse ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Neni 5

Vlerësimi me projekt kurrikular

1. Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë të gjithë vitit shkollor.
2. Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërnlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxënësi ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxënësi dhe mund të zhvillohet individualisht ose në grup.
3. Drejtoria e shkollës planifikon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
4. Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
5. Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Neni 6

Vlerësimi i të nxënësit

Vlerësimi i të nxënësit të nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a) vlerësimit periodik,
- b) vlerësimit përfundimtar.

Neni 7

Vlerësimi periodik në klasat IV–XII

1. Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 nota:
 - a) notën e vlerësimit të vazhduar;
 - b) notën e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse.
2. Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo periudhe.

Neni 8

Vlerësimi përfundimtar në klasat IV–XII

1. Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.
2. Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - a) notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha;

- b) notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse për tri periudha;
 c) notën e vlerësimit të projektit.
 3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit	Pesha në përqindje klasat IV–V	Pesha në përqindje klasat VI–XII
Vlerësimi i vazhduar	45%	40%
Vlerësimi me test/detyrë përmblendhëse	30%	40%
Vlerësimi i projektit kurrikular	25%	20%

4. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:
- a) Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- b) Nota vjetore e vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse (NTp/Dp) përcaktohet bazuar në tri notat e vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- c) Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në ecurinë e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar;
- d) Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh. 8,8 9);
- e) Formulatat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:
- I. nota përfundimtare në klasat IV–V = $(NVv \times 0.45) + (NTp \text{ ose } Dp \times 0.3) + (NVp \times 0.25)$;
- II. nota përfundimtare në klasat VI–XII = $(NVv \times 0.4) + (NTp \text{ ose } Dp \times 0.4) + (NVp \times 0.2)$;
- f) Dokumentimi në regjistrë të rezultateve të vlerësimit të të nxënësit sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë shtator–dhjetor		Periudha e dytë janar–mars		Periudha e tretë prill–qershor		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NVv	NT ose Dp	NVv	NTp ose Dp	NVv	NTp ose Dp	NVv	NTp ose Dp	NVp	

Neni 9

Vlerësimi i nxënësit në klasat I–III

1. Vlerësimi i nxënësit në klasat I–III përfshin vlerësimin përshkrues, vlerësimin përmblendhës dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësit.
2. Vlerësimi përshkrues bëhet në përfundim të secilës periudhë të vitit shkollor. Ai mbështetet:
- a) në përgatitjen dhe në performancën sistematike të nxënësit që përbën 45% të peshës së vlerësimit;
- b) në punimet krijuese dhe nismat individuale, produktet dhe detyrat specifike që nxënësi bën në grup për realizimin e projektit kurrikular që përbën 25% të peshës së vlerësimit dhe ka lidhje me interesin e nxënësit për të nxënë;
- c) në diktimet dhe testimet që përbëjnë 30% të peshës së vlerësimit, të cilat dëshmojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të të nxënësit të nxënësit.
3. Vlerësimi përshkrues bëhet me përshkrim për secilën kompetencë të fushave të të nxënësit/lëndëve të arsimit fillor. Në regjistrë, vlerësimi përshkrues i nxënësit realizohet me kodet 1–5, të cilat përkohet me 5 nivelet e arritjes së kompetencave:
- a) *Niveli 1 “Arritje të pakënaqshme”*, kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënësit;

b) *Niveli 2 “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”*, kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënës dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit;

c) *Niveli 3 “Arritje të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të të nxënës dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë;

d) *Niveli 4 “Arritje shumë të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënës;

e) *Niveli 5 “Arritje të shkëlqyera”*, kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënës.

4. Vlerësimi përmbledhës mbështetet në tri vlerësimet përshkruese, duke pasur parasysh përparimin progresiv të nxënës. Ai realizohet me kodet nga 1–5, sipas 5 niveleve të arritjes së kompetencave.

5. Vlerësimi përfundimtar i nxënës bëhet për lëndën dhe shënohet me kod dhe me emërtim të shkurtuar të niveleve të vlerësimit: 1 (APK), 2 (ANP), 3 (AK), 4 (AShK) dhe 5 (ASh).

Neni 9/1

Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit artistik

(shtuar me udhëzimin nr. 9, datë 21.3.2023)

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Për të gjitha lëndët e kurrikulës artistike, vlerësimi realizohet në dy periudha, si më poshtë:

a) periudha e parë: shtator – janar;

b) periudha e dytë: shkurt – qershor.

3. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënës për lëndët e kurrikulës artistike sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë” dhe “Koreografi”, të jetë si më poshtë:

Periudha e parë		Periudha e dytë		Vlerësimi vjetor		Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	

4. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

5. Procedura për përllogaritjen e notës përfundimtare vjetore, është:

a) nota vjetore e vlerësimit të vazhduar teknik përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teknik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

b) nota vjetore e detyrës përmbledhëse (saxho) përcaktohet bazuar në dy notat e detyrës përmbledhëse (saxho) të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

c) nota përfundimtare përcaktohet bazuar në notën vjetore të vlerësimit të vazhduar teknik dhe notën vjetore të detyrës përmbledhëse (saxho).

6. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënës për lëndët e kurrikulës artistike, sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik, në degën “Art figurativ”, është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	

--	--	--

7. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

8. Nota përfundimtare përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teorik dhe praktik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.

9. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë”, “Koreografi” dhe “Art figurativ” vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

Neni 9/2

Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit sportiv

(shtuar me udhëzimin nr. 9, datë 21.3.2023)

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit sportiv vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Neni 10

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

1. Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara (AK), për nxënësit që punojnë me Plan Edukativ Individual (PEI), të bëhet bazuar në rezultatet e të nxënit të përcaktuara në PEI sipas rubrikave të këtij plani, i ndarë në periudha.

2. Për nxënësit me AK që punojnë me kurrikulën e zakonshme vlerësimi kryhet njësoj si për nxënësit e tjerë.

Neni 11

Raportimi i arritjeve dhe i përparimit të nxënësve

1. Raportimi i arritjeve të të nxënit bëhet nga mësuesi një herë për secilën periudhë dhe i jepet me shkrim personit që ushtron përgjegjësinë prindërore/kujdestarit ligjor të fëmijës.

2. Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve ka dy qëllime kryesore:

a) së pari siguron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm rreth të nxënit të nxënësve dhe përparimit të tyre, duke shërbyer si bazë për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënit;

b) së dyti krijon një platformë, e cila u shërben mësuesve dhe prindërve të mbështesin nxënësit në hapat e mëtejshëm të të nxënit, si dhe vetë nxënësve të zhvillohen në këtë proces.

3. Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve bazohet në notat e vlerësimit të vazhduar, testet/detyrat përmbledhëse, si dhe nota e projektit kurrikular.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Testet, detyrat përmbledhëse dhe projekti kurrikular të nxënësit janë objekt monitorimi deri në fund të vitit shkollor.

2. Ky udhëzim fillon zbatimin në vitin shkollor 2022–2023.

3. Udhëzimi nr. 34, datë 11.9.2015, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca për arsimin bazë” dhe udhëzimi nr. 14, datë 28.7.2016, “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”, shfuqizohen.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi